



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

MINISTRIA E MBROJTJES

Nr 4644/2 dt 18.5.2026

MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

Nr 4321/1 prot, date 19.05.2026

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 1036, datë 18.5.2026

**PËR MIRATIMIN E FORMATEVE TË KËRKESAVE PËR PAJISJEN ME
AUTORIZIM IMPORTI, EKSPORTI DHE TRANSITI TË ARMËVE TË
ZJARRIT, TË KOMPONENTËVE TË TYRE KRYESORË DHE TË
MUNICIONEVE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 36, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe ligjit nr. 13/2026, "Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve", ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit;

URDHËROJMË:

1. Miratimin e formateve të kërkesave për pajisjen me autorizim importi, eksporti dhe transiti të armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve, sipas shtojcave bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. ✓

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



MINISTËR I MBROJTJES

Ermal Nufi

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT



Delina Ibrahimaj

**UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E KËRKESAVE PËR PAJISJEN ME
AUTORIZIM IMPORTI, EKSPORTI DHE TRANSITI TË ARMËVE TË
ZJARRIT, TË KOMPONENTËVE TË TYRE KRYESORË DHE TË
MUNICIONEVE**

Subjekti kërkues përcakton llojin e autorizimit të kërkuar në hapësirën e dedikuar: “Lloji i autorizimit”, duke vendosur me shenjën dalluese (x).


Në rubrikën më poshtë, me shenjën dalluese (x), subjekti vendos nëse zbatohet ndonjë prej regjimeve (import i përkohshëm ose transit).


Gjithashtu, subjekti, me shenjën dalluese (x), përcakton llojin e armës, nëse është e pa konvertueshme për alarm dhe sinjalizim, armë zjarri e çaktivizuar me certifikatë ose armë zjarri e çaktivizuar pa certifikatë. Në rastin e armës së zjarrit të çaktivizuar me certifikatë, subjekti paraqet certifikatën përkatëse.


1. Në kutinë ku është vendosur “*Nr. i importuesit*” do të plotësohen të dhënat e identifikimit të subjektit me numrin unik identifikues (NUIS/NIPT), qoftë person fizik ose juridik, adresa dhe të dhënat e kontaktit (e-mail; nr. telefoni).
2. Në kutinë ku është vendosur “*Numri i identifikimit të licencave/autorizimeve*” do të plotësohen të dhënat e numrit të licencës sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 3 e ligjit nr. 13/2026.
3. Në kutinë ku është vendosur “*Data e skadimit të licencave/autorizimeve*” do të vendoset data e skadimit të licencës/autorizimit/lejes të përcaktuar në rubrikën nr. 2.
4. Në kutinë ku është vendosur “*Të dhënat e pikës së kontaktit*”, do të plotësohen të dhënat e përfaqësuesit të subjektit me: nr. e telefonit, adresë e-mail, shoqëruar me një kopje të mjetit të identifikimit (ID) të përfaqësuesit të subjektit.
5. Në kutinë ku është vendosur “*Marrësi*”, sipas rastit, do të plotësohen të dhënat e identifikimit të subjektit marrës me numrin unik identifikues (NUIS/NIPT), qoftë person fizik ose juridik, adresa dhe të dhënat e kontaktit (e-mail; nr. telefoni).
6. Në kutinë ku është vendosur “*Autoriteti lëshues i licencave/autorizimeve*”, do të vendoset autoriteti përgjegjës që ka lëshuar licencën/autorizimin/lejen e përcaktuar në rubrikën nr. 2.
7. Në kutinë ku është vendosur “*Nr. i agjentit(ëve)/përfaqësuesit(ve)*”, nëse është i ndryshëm nga eksportuesi, do të plotësohen të dhënat e identifikimit të subjektit me numrin unik identifikues (NUIS/NIPT), qoftë person fizik ose juridik, adresa dhe të dhënat e kontaktit (e-mail; nr. telefoni).
8. Në kutinë ku është vendosur “*Vendet e importit*” do të vendoset vendi ku do të importohet malli për të cilin kërkohet autorizimi (Republika e Shqipërisë). Kodi është kodi i shtetit, shkurtimi sipas standardit ndërkombëtar, p.sh.: “Shqipëria (AL)”.
9. Në kutinë ku është vendosur “*Vendet e eksportit dhe numrat e autorizimeve për eksport*” do të vendosen vendi nga kanë ardhur mallrat, si dhe numri i autorizimit për eksport të lëshuar nga vendi eksportues, Subjekti duhet që të paraqesë pranë AKSHE një kopje të këtij autorizimi. Kodi është kodi i shtetit, shkurtimi sipas standardit ndërkombëtar, p.sh.: “Shqipëria (AL)”.
10. Në kutinë ku është përcaktuar “*Përfituesit fundorë*” duhet të përcaktohet se cili subjekt privat ose shtetëror do të jetë përfituesi i fundit në vendin e destinacionit të fundit.


* **Shënim:** në rastin kur kërkohet autorizim për import të përkohshëm sipas shkronjës b) të pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr. 13/2026, subjekti ka detyrimin e paraqitjes në dosjen e aplikimit të një deklarate dhe dokumentacionit shoqërues duke specifikuar të gjitha detyrimet që përcakton kjo pikë.


11. Në kutinë ku është vendosur “*Vendet përmes së cilave kalon dërgesa*” (në rast kur ka), duhet të përcaktohen vendet ku malli do të kalojë transit gjatë rrugëtimit për në destinacionin e fundit. Kodi është kodi i shtetit, shkurtimi sipas standardit ndërkombëtar, p.sh.: “Shqipëria (AL)”. Subjekti duhet të paraqesë në dosjen e aplikimit dokumentacionin që vërteton se vendet transit nuk kanë kundërshtime për transferimin.
12. Në kutinë ku është përcaktuar “*Pika doganore ku do të kryhet importi*” duhet të përcaktohet pika doganore në Republikën e Shqipërisë ku do të kryhet importi.
13. Në kutinë ku është vendosur “*Përshkrimi i artikujve*”, do të vendosen të dhënat e mallit, duke përfshirë emrin, kodin, etj. Subjekti në dosjen e aplikimit duhet të paraqesë dokumentacionin shoqërues që mundëson identifikimin e mallrave objekt autorizimi, si dhe sasinë e tyre, dukë përfshirë, të paktën para dërgimit, markimin e vendosur në armën e zjarrit ose në komponentët kryesorë.
- 13.a. Në kutinë ku është përcaktuar “*Markim*” do të vendoset markimi i mallrave sipas kërkesave për markimin të parashikuara në legjislacionin në fuqi për armët dhe në Protokollin e OKB-së për armët e zjarrit.
14. Në kutinë ku është përcaktuar “*Kodi i sistemit të harmonizuar ose nomenklatura e kombinuar*” duhet të përcaktojë kodin doganor të mallrave sipas nomenklaturës së mallrave dhe kodeve tarifore doganore.
15. Në kutinë ku është përcaktuar “*Monedha dhe vlera*” duhet të përcaktojë llojin e monedhës, p.sh Euro, Lekë, Dollari Amerikan, Dollari Kanadez, si dhe vlerën për çdo produkt si shumatorë e sasisë së tij.
16. Në kutinë ku është përcaktuar “*Sasia e artikujve*” duhet të përcaktojë sasinë e mallrave për të cilën kërkohet autorizimi sipas njësisë (copë, kilogram), dhe shifrën të shprehur në numra.
17. Në kutinë ku është përcaktuar “*Përdorimi fundor*” duhet të përcaktojë se cili është qëllimi i përdorimit të fundit të mallit, nga përdoruesi i fundit.
18. Në kutinë ku përcaktohet “*Data e kontratës*” përcaktohet data e lidhjes së kontratës/porosisë për eksportin/importin e mallrave. Subjekti në dosjen e aplikimit duhet të paraqesë një kopje të njësuar të kësaj kontrate/porosie.
19. Në kutinë ku është përcaktuar “*Procedura doganore*” duhet të përcaktohet lloji i procedurës doganore ose formalitetet doganore sipas nenit 5 të ligjit nr. 13/2026.
20. Në kutinë ku përcaktohet “*Autorizoj Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të verifikojë të dhënat e subjektit aplikues mbi:*
 - *Gjendjen gjyqësore (penal dhe civile) lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor ku subjekti ka selinë.*
 - *Gjendjen e procedimit penal nga Prokuroria.*
 - *Gjendjen e mbi detyrimet ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë apo shtetërorë nga Përmbarimi.*
 - *Gjendjen për shlyerjen e detyrimeve nga dega e tatim-taksave*”, subjekti vendos shenjën dalluese (x), duke pranuar administrimin e të dhënave personale nga Autoriteti, në funksion të procesit të pajisjes me autorizimin përkatës.
21. Në kutinë ku përcaktohet “*Deklaroj nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore se i gjithë informacioni*”, subjekti vendos shenjën dalluese (x), duke pranuar përgjegjësinë e tij lidhur me vërtetësinë e të dhënave të deklaruara dhe dokumentacionit të paraqitur.


	REPUBLIKA E SHQIPËRISË	KËRKESË PËR AUTORIZIM IMPORTI TË ARMËVE TË ZJARRIT		Ligji Nr. __/____	
	Lloji i autorizimit:	I vetëm <input type="checkbox"/>	I shumëfishtë <input type="checkbox"/>	I përkohshëm <input type="checkbox"/>	
Armë të pa konvertueshme për alarm dhe sinjalizim <input type="checkbox"/>		Armë zjarri të çaktivizuara me certifikatë <input type="checkbox"/> Armë zjarri të çaktivizuara pa certifikatë <input type="checkbox"/>			
KËRKESË PËR AUTORIZIM	1.	1. Importuesi: Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	2. Numri i identifikimit të licencave/autorizimeve	3. Data e skadimit të licencave/autorizimeve	
			4. Të dhënat e pikës së kontaktit		
		5. Marrësi(t): Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	6. Autoriteti lëshues i licencave/autorizimeve		
		7. Eksportuesi (agjenti/përfaqësuesi, nëse është i ndryshëm nga eksportuesi): Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	8. Vendet e importit	Kodi	
			9. Vendet e eksportit dhe numrat e autorizimeve për eksport	Kodi	
		10. Përfituesit fundorë (nëse dihen në kohën e dërgesës): Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	11. Vendet përmes së cilave kalon dërgesa (sipas rastit)	Kodi	
			12. Piken doganore ku do kryhet importi	Kodi	
		13. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i sistemit të harmonizuar ose i nomenklaturën e kombinuar (sipas rastit - me 8 shifra)		
		13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve	
		17. Përdorimi fundor	18. Data e kontratës (sipas rastit)	19. Procedura doganore	
		20. Autorizoj Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të verifikojë të dhënat e subjektit aplikues dhe administratorit mbi: <ul style="list-style-type: none"> Gjendjen gjyqësore (penal dhe civile) lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor. Gjendjen e procedimit penal nga Prokuroria. Dëshmi penalteti (për administratorin). 			
		21. Deklaratë mbi përgjegjësinë ligjore mbi të dhënat e deklaruara në formular: <ul style="list-style-type: none"> Deklaroj nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore se i gjithë informacioni që përmban kjo kërkesë dhe dokumentacioni bashkëlidhur është i saktë dhe kërkoj lëshimin e autorizimit nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. 			
		Për t'u plotësuar nga subjekti kërkuar:			
	Nënshkrimi:	Vula:			
	Përfaqësuesi i subjektit:				
	Vendi dhe data:				

	REPUBLIKA E SHQIPËRISË	KËRKESË PËR AUTORIZIM IMPORTI TË ARMËVE TË ZJARRIT		
KËRKESË PËR AUTORIZIM	1a.	1. Importuesi	2. Numri i identifikimit	9. Vendet e eksportit dhe numrat e autorizimeve për eksport
			5. Marrësi	
		13.1. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
		13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
		13.2. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
		13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
		13.3. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
		13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
		13.4. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
		13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
		13.5. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
		13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
		13.6. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
		13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve

	REPUBLIKA E SHQIPËRISË		KËRKESË PËR AUTORIZIM EKSPORTI TË ARMËVE TË ZJARRIT		Ligji Nr. __/____	
	Lloji i autorizimit:		I vetëm <input type="checkbox"/> Rieksport <input type="checkbox"/>	I shumëfishtë <input type="checkbox"/> I përkohshëm <input type="checkbox"/>	I thjeshtuar <input type="checkbox"/>	
Armë të pa konvertueshme për alarm dhe sinjalizim <input type="checkbox"/>			Armë zjarri të çaktivizuara <input type="checkbox"/>			
KËRKESË PËR AUTORIZIM	1.	1. Aplikanti/eksportuesi: Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	2. Numri i identifikimit të licencave/autorizimeve	3. Data e skadimit të licencave/autorizimeve		
			4. Të dhënat e pikës së kontaktit			
		5. Marrësi(t): Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	6. Autoriteti lëshues			
		7. Importuesi (agjenti/përfaqësuesi, nëse është i ndryshëm nga importuesi): Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	8. Vendet e eksportit	Kodi		
			9. Vendet e importit dhe numrat e autorizimeve për import	Kodi		
		10. Përfituesit fundorë (nëse dihen në kohën e dërgesës): Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	11. Vendet e përmes së cilave kalon dërgesa (sipas rastit)	Kodi		
			12. Piken doganore ku do kryhet eksporti	Kodi		
		13. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i sistemit të harmonizuar ose i nomenklaturën e kombinuar (sipas rastit - me 8 shifra)			
		13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve		
		17. Përdorimi fundor	18. Data e kontratës (sipas rastit)	19. Procedura e eksportit doganor		
	20. Autorizoj Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të verifikojë të dhënat e subjektit aplikues dhe administratorit mbi: <ul style="list-style-type: none"> Gjendjen gjyqësore (penal dhe civile) lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor. Gjendjen e procedimit penal nga Prokuroria. Dëshmi penaliteti (për administratorin). 					
	21. Deklaratë mbi përgjegjësinë ligjore mbi të dhënat e deklaruara në formular: <ul style="list-style-type: none"> Deklaroj nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore se i gjithë informacioni që përmban kjo kërkesë dhe dokumentacioni bashkëlidhur është i saktë dhe kërkoj lëshimin e autorizimit nga Autoriteti I Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. 					
	<div style="border: 1px solid black; padding: 5px;"> Për t'u plotësuar nga subjekti kërkuar: Nënshkrimi: _____ Vula: _____ Përfaqësuesi i subjektit: Vendi dhe data: _____ </div>					

	REPUBLIKA E SHQIPËRIË	KËRKESË PËR AUTORIZIM EKSPORTI TË ARMËVE TË ZJARRIT	
1a.	1. Eksportuesi	2. Numri i identifikimit	9. Vendet e importit dhe numrat e autorizimeve për import
KËRKESË PËR AUTORIZIM		5. Marrësi	
	13.1. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
	13.2. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
	13.3. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
	13.4. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
	13.5. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve
	13.6. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)	
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve

	REPUBLIKA E SHQIPËRISË	KËRKESË PËR AUTORIZIM TRANSITI TË ARMËVE TË ZJARRIT		Ligji Nr. __/ __	
Armë të pa konvertueshme për alarm dhe sinjalizim <input type="checkbox"/>		Armë zjarri të çaktivizuara me certifikatë <input type="checkbox"/> Armë zjarri të çaktivizuara pa certifikatë <input type="checkbox"/>			
KËRKESË PËR AUTORIZIM	1. Aplikuesi/Agjenti/Transituesi: Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	2. Numri i identifikimit të licencave/autorizimeve	3. Data e skadimit të licencave/autorizimeve		
		4. Të dhënat e pikës së kontaktit			
	5. Marrësi(t)/Importuesit: Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	6. Autoriteti lëshues i licensave/autorizimeve			
	7. Eksportuesit: Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	8. Vendet e importit dhe numrat e autorizimeve për import	Kodi		
		9. Vendet e eksportit dhe numrat e autorizimeve për eksport	Kodi		
	10. Përfituesit fundorë (nëse dihen në kohën e dërgesës): Adresa: Telefoni: NUIS/NIPT:	11. Vendet përmes së cilave kalon dërgesa dhe numrat e autorizimeve për transit	Kodi		
		12. Kompania transportuese dhe mënyra e transportit			
	13. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i sistemit të harmonizuar ose i nomenklaturën e kombinuar (sipas rastit - me 8 shifra)			
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve		
	17. Përdorimi fundor	18. Data e kontratës (sipas rastit)	19. Procedura doganore		
		20. Pika Doganore Hyrëse (Entry customs office)	21. Pika Doganore Dalëse (Exit customs office)		
	22. Deklaratë mbi përgjegjësinë ligjore mbi të dhënat e deklaruara në formular: <ul style="list-style-type: none"> Deklaroj nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore se i gjithë informacioni që përmban kjo kërkesë dhe dokumentacioni bashkëlidhur është i saktë dhe kërkoj lëshimin e autorizimit nga Autoriteti I Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. 				
	<div style="border: 1px solid black; padding: 5px;"> Për t'u plotësuar nga subjekti kërkues: Nënshkrimi: _____ Vula: _____ Përfaqësuesi i subjektit: Vendi dhe data: _____ </div>				

	REPUBLIKA E SHQIPËRISË	KËRKESË PËR AUTORIZIM TRANSITI TË ARMËVE TË ZJARRIT		
1a.	1. Aplikuesi/Agjenti/Transituesi:	2. Numri i identifikimit	9. Vendet e transitit dhe numrat e autorizimeve për eksport/ transit/ import	
KËRKESË PËR AUTORIZIM		5. Marrësi(t)/Importuesit:		
	13.1. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)		
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve	
	13.2. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)		
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve	
	13.3. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)		
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve	
	13.4. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)		
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve	
	13.5. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)		
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve	
	13.6. Përshkrimi i artikujve	14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)		
	13.a. Markim	15. Monedha dhe vlera	16. Sasia e artikujve	

RELACION

PËR

PROJEKT-URDHRIN

PËR MIRATIMIN E FORMATEVE TË KËRKESAVE PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM IMPORTI, EKSPORTI DHE TRANSITI TË ARMËVE TË ZJARRIT, TË KOMPONENTËVE TË TYRE KRYESORË DHE TË MUNICIONEVE

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projekt-urdhri është përcaktimi formateve të kërkesave për pajisjen me autorizim importi, eksporti dhe transit të armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Subjektet të cilat kërkojnë të pajisjen me autorizim për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve në dhe përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë detyrimin e plotësimit të formularëve tip sipas kërkesave të ligjit nr. 13/2026 “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projekt-urdhri nuk është parashikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2026. Megjithatë, hartimi dhe miratimi i tij vlerësohet i domosdoshëm si rrjedhojë e miratimit të ligjit nr. 13/2026, “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Hartimi i projekt-urdhrit për miratimin e formateve të kërkesave për pajisjen me autorizim importi, eksporti dhe transiti të armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve vlerësohet i domosdoshëm si rrjedhojë e miratimit të ligjit nr. 13/2026. Ky ligj përcakton kuadrin e përgjithshëm rregullator për veprimtaritë e importit, eksportit dhe transimit, por nuk parashikon formate të standardizuara të kërkesave. Ky projekt-urdhër është vlerësuar gjithashtu i nevojshëm për të lehtësuar procesin e aplikimit, trajtimin e kërkesave nga subjektet e interesuara, si dhe për të marrë të gjitha të dhënat e nevojshme që i shërbejnë procesit të dhënies së autorizimit.

Nxjerrja e këtij projekt-urdhri është mbështetur në nenin 36, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, i ndryshuar, i cili i jep kompetencë ministrave për të miratuar formularët e kërkesave të

licencave/autorizimeve/lejeve dhe të nënkategorive të tyre. Referuar Shtojcës 1, të ligjit nr. 10 081/2009, kategoria e kësaj veprimtarie është pjesë e *Fushës I, Siguria kombëtare, rendi publik dhe mbrojtja civile*.

Me miratimit e këtij akti sigurohet unifikimi dhe standardizimi i procedurave, duke shmangur interpretimet e ndryshme dhe duke rritur transparencën. Së dyti, lehtësohet puna e administratës publike në shqyrtimin e kërkesave, pasi formatet e qarta dhe të detajuara reduktojnë gabimet dhe vonesat. Së treti, subjektet private që kërkojnë autorizime për import, eksport apo transit do të kenë udhëzime të qarta dhe të aksesueshme, çka rrit sigurinë juridike dhe besimin në institucionet publike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt-urdhri mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 36, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 13/2026, “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve”.

V. PËRMBAJTJA E PROJEKTAKTIT

Nëpërmjet këtij projekt-urdhri, përcaktohen formatet e kërkesave të aplikimit për pajisjen me autorizim importi, eksporti dhe transiti të armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Në pikën 1, është parashikuar miratimi i formateve të kërkesave sipas shtojcave, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij urdhri.

Subjektet të cila ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e importit, eksportit dhe transimit të armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve, kanë detyrimin të paraqesin kërkesat e tyre, në varësi të objektit të veprimtarisë së tyre, në një prej formave të mëposhtme:

1. Kërkesë për autorizim importi të armëve të zjarrit;
2. Kërkesë për autorizim eksporti të armëve të zjarrit;
3. Kërkesë për autorizim për transit të armëve të zjarrit.

Në formularin nr. 1 “*Kërkesë për autorizim importi të armëve të zjarrit*”, janë të përfshira 3 shërbime të cilat, subjekti i zgjedh në varësi të veprimtarisë, si më poshtë:

- a) Kërkesë për autorizim të vetëm për import;
- b) Kërkesë për autorizim të shumëfishtë për import;
- c) Kërkesë për autorizim të vetëm për import të përkohshëm.

Në formularin nr. 2 “Kërkesë për autorizim eksporti të armëve të zjarrit”, janë gjithashtu të përfshira 3 shërbime të cilat subjekti i zgjedh në varësi të veprimtarisë, si më poshtë:

- a) Kërkesë për autorizim të vetëm për eksport;
- b) Kërkesë për autorizim të shumëfishtë për eksport;
- c) Kërkesë për autorizim të thjeshtuar për eksport (rieksport, eksport i përkohshëm);

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektvendimit nuk sjell detyrime shtesë dhe nuk krijon shpenzime të reja për buxhetin e shtetit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektvendimi ka kontribuar Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

MINISTËR I MBROJTJES

Ermal Nuhi



MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Delina Ibrahimaj

